



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
ZËDHËNËSI

Tiranë, më 08.10.2014

Njoftim për web

KLSH kallëzon në Prokurori ish-Drejtorin e Përgjithshëm dhe dy ish-ZVDrejtorët e Autoritetit Rrugor Shqiptar
- Dëmi ekonomik mbi 500 mijë dollarë-

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të tij të auditimit nr. 246/1 prot, datë 06.03.2014, i ndryshuar, zhvilloi auditim në Autoritetin Rrugor Shqiptar, Tiranë, në përfundim të të cilit u konstatuan një sërë shkeljesh të legjislacionit në fuqi, të kryera nga ana e ish Drejtorit të Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) si dhe dy ish Zv/Drejtorë të këtij institucioni.

Më konkretisht, nga auditimi me zgjedhje i kontratave të lidhura për vitin 2013, rezultoi se ARrSh kishte aplikuar kushtin e “paradhënies” ndaj subjekteve të ndryshme kontraktore, në kundërshtim me kriteret dhe procedurat përkatëse ligjore për dhënien e tyre.

Nga auditimi i këtyre kontratave, rezultoi që:

- Ato ishin lidhur para se të merrej miratimi me shkrim nga Ministri i Financave.
- ARrSh nuk ka patur asnjë arsye që përderisa në dokumentet standarde të tenderit nuk parashikohej kushti i paradhënies ti favorizonte OE fitues duke aplikuar kushtin e paradhënies në momentin e lidhjes së kontratës me ta.
- Nga ana e operatorëve ekonomik përfitues të paradhënies, nuk ishte bërë asnjë kërkesë paraprake për paradhënie dhe për rrjedhojë ARrSH i ka iniciuar procedurat e paradhënies me vetë nismën e saj.
- ARrSh nuk kishte ezauruar paraprakisht procedurat normale të marrjes në dorëzim nga OE të sheshit për kryerjen e punimeve, njoftimit për fillimin e punimeve, si dhe argumentimit të shumës që ARrSh kërkonte ti jepte paradhënie OE, procedura këto të cilat duhet të ishin përmbyllur nga ARrSh përpara se ajo të kërkonte miratimin e Ministrisë së Financave.

Pavarësisht shkeljeve të mësipërme, nga auditimi rezultoi që ish-Drejtori i Përgjithshëm i ARrSh, u kishte dhënë paradhënie secilit prej operatorëve ekonomikë **një vlerë në lekë më të madhe nga ajo që kishte miratuar Ministri i Financave** dhe madje **në një rast kishte vendosur vetë shifrën e paradhënies që do t'i jepej operatorit ekonomik.**

Më konkretisht nga auditimi rezultoi që shuma totale që ARrSh u ka dhënë si paradhënie në mënyrë të kundraligjshme operatorëve ekonomikë është 261,700,000 lekë, nga të cilat 3,300,000 lekë u janë dhënë tepër mbi vlerën e miratuar nga Ministri i Financave dhe 105,100,000 lekë pa miratimin e Ministrit, por vetëm me urdhërin e ish-Drejtorit të ARrSh.

Sa më sipër, ARrSh në ekzekutimin e këtyre paradhënieve në favor të operatorëve ekonomikë, ka vepruar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e vitit 2013”, Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrisë së Financave, pika 147, Shkresën nr. 9392/1,

datë 13.6.2013 të Ministrit të Financave, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime, neni 41/1, 59/1, si dhe VKM nr. 1, datë 10.1.2007 me ndryshime “Për Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, kreu III, pika 1/a.

Në kushtet kur shteti nuk ka patur asnjë detyrim kontraktor ndaj operatorëve ekonomikë për dhënien ndaj tyre të një paradhënie, si dhe në kushtet kur operatorëve ekonomikë kanë ofruar paraprakisht, që në fazën e zhvillimit të procedurave të tenderimit, të gjithë garancinë e nevojshme për përballimin e shpenzimeve të punimeve (çka përbën dhe një nga kriteret e shpalljes së tij si fitues të këtij tenderi), ARrSh ka vendosur të favorizojë që në fillim këta operatorëve ekonomikë (përpara se ata të fillonin kryerjen e punimeve) duke iu dhënë atyre mundësinë që këto punime (sot e kësaj dite ende të pakryera) këta operatorëve ekonomikë t’i kryenin me lekët e Shtetit dhe jo nëpërmjet kapitalit që këta operatorëve ekonomikë pretendonin që e zotëronin për kryerjen e punimeve përpara dhe gjatë zhvillimit të tenderit.

Njëkohësisht, nga auditimi me zgjedhje i prokurimeve të zhvilluara në lidhje me rikonstruksionin dhe zgjerimin e rrugëve, u konstatua një rritje fiktive e çmimit për njësi të zërit të punimeve. Më konkretisht, nga auditimi rezultoi se Autoriteti Rrugor Shqiptar kishte punuar me dy standarde gjatë të njëjtës periudhë kohore, duke pranuar çmime të ndryshme për të njëjtin zë punimesh, si pasojë e të cilave i është shkaktuar buxhetit të shtetit **një dëm ekonomik i përlogaritur në vlerën 56,863,332 lekë (me TVSH).**

Për të gjitha shkeljet e konstatuara më sipër, **KLSH ka kryer kallzim penal në Prokurori për A.T, ish-Drejtor i Përgjithshëm i ARrSh, për S.Ç., ish Zv/Drejtor, dhe për L.K, ish-Drejtor i Drejtorisë Teknike, të cilët, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre funksionale, kanë kryer veprime apo mosveprime të kundërligjshme, duke konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, sipas neni 248 të Kodit Penal.**